



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr. _____ Prot .

Korçë, më ____ .05.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Materiale ndërtimi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

-Materiale ndërtimi (44110000-4)

-Produkte të lidhura me materiale ndërtimi (44140000-3)

VLERA E FONDIT LIMIT: 39,582,180 (tridhjet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë)lekë PA TVSH.

Ose 402,135 (katërqind e dy mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) Euro, pa TVSH.

Në përlllogaritjen e cmimit të materialeve grupi I punës ka marrë cmimet e materialeve nga Manuali i Çmimeve të Ndërtim të vitit 2023 dhe për produktet 6,7,8,9 ka marrë tre oferta në treg në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 76, paragrafi I (parë) pika a) dhe b) ,të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Korçë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare: **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se **40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- a) **2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të dorezojnë :** Operatori duhet të paraqesë jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit **mostrat** e materialeve të mëposhtme të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve teknike:

Gurë kalldremi gri, të zezë	Nga 1 copë për secilën ngjyrë
Bordura guri gri, të zezë	Nga 1 copë për secilën ngjyrë dhe përmasë
Pllaka guri trotuari	1 copë

Mostrat duhet të dorezohen jo më vonë se data dhe ora e hapjes së tenderit. Mos dorëzimi i mostrave brenda afatit do të sjellë skualifikimin e operatorit pjesëmarrës.

Mostrat janë kërkuar për arsye se në Autoritet Kontraktor meremi me mirembajtje dhe riparime, prandaj bordurat dhe pllakat e betonit nuk mund të marim lloj (ngjyre dhe forme) tjetër për shkak të riparimeve të kalldremeve ekzistuese .

Argumentimi:

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e *mostrave të mallit* është përcaktuar proporcionalisht dhe në përputhje me objektin e kontratës, bazuar në nenin 77, të LPP, si dhe nenin 40, par.6, pika a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë përputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

2.4.2 Dëshmi për fuqinë mesatare puntore të operatorit ekonomik :

Një punësim mestar prej të paktën 3 **(tre) persona** të cilët të jenë 2 shoferë, 1 manovrator për periudhën **shkurt 2025 - prill 2025** e dokumentuar kjo me vërtetimin e pagesës së sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi

Për shoferët duhet të paraqitet

- Çertifikatën e aftësisë profesionale të lëshuar nga zyra kompetente e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Lejë drejtimin e lëshuar nga dega e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.
- Kontrata e punës.

Argumentimi për fuqinë punëtore të kërkuar.

- 2 shoferë të cilët duhen për të drejtuar kamionët me peshë mbi 3.5 dhe mbi 10 ton.
- 1 manovrator i cili duhen për të operuar me kamionin vinç.

Respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet që shoferët të figurojnë në listat e pagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.4.3 Disponimi i mjeteve të meposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Kamion Vinc	1	Pronësi ose me qira
2	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 3.5 ton	1	Pronësi ose me qira
3	Mjet transporti me peshëmbajtje mbi 10 ton	1	Pronësi ose me qira
6	Nyje thyerje te materialeve inerte	1	Në pronësi, me qera ose kontrate furnizimi

Për mjetet e transportit duhet të paraqiten: në rast se janë në pronësi dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e pronësisë, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit dhe foto te mjetit ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Kur mjetet janë me qira duhet të paraqitet: kontrata e qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi, e shoqëruar me lejën e qarkullimit, çertifikatën e pronësisë, çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit foto te mjetit ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Për Nyjen e thyerjes te materialeve inerte duhet te paraqitet: në rast se është në pronësi dokumente që vërtetojnë pronësinë (çertifikate pronësie dhe/ose faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganim) dhe lejën mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Kur Nyja e thyerjes është me qira duhet të paraqitet: kontrata e qirasë e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë (çertifikatë pronësie dhe/ose faturë tatimore dhe/ose faturë zhdoganim) e nyjes dhe lejën mjedisore (duhet të paraqitet leja mjedisore Kodi III.1B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit ose lejë mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.)

Në rast se nuk është në pronësi apo me qira Nyje thyerje të materialeve inerte: duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me prodhuesin ku të jetë i përcaktuar:

- a. furnizimi i vazhdueshëm dhe sipas kërkesës
- b. sasia dhe afati i përfundimit të kontratës

Argumentimi për mjetet që duhet të disponohen:

1.Kamion vinç i cili do të përdoret për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve që transportohen në paleta.

2.Kamion mbi 3.5 ton i cili do të përdoret për transportin e materialeve të ndërtimit në sasi jo shumë të madhe(sipas kërkesave) dhe materialeve që transportohen në paleta.

3.Kamion mbi 10 ton i cili do të përdoret për transportin e materialeve të ndërtimit si: granil, stabilizant, çakëll, gurë për mure.

4.Nyja e thyerjes e cila do të përdoret për prodhimin e materialeve si:granili,stabilizanti dhe çakëlli .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Disponimi i mjeteve/pajiseje të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazës së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës duhet t’i dergojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehësuar me origjinalin. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht për s’kualifikimin e OE.

2.4.4 Për mjetet e mësipërme OE duhet të paraqesë Çertifikatë për transportin e mallrave.

Argumentim: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin Neni 45 të LIGJIT Nr.8308, datë 18.3.1998 PËR TRANSPORTET RRUGORE, të përditësuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë **Çertifikatën për transportin e mallrave**, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

➤ Analiza laboratorike të materialeve të ndërtimit :

- Analiza për granilin.
- Analiza për stabilizantin.
- Analiza për çakullin.
- Analiza për gurët e kalldrëmit.
- Analiza për bordurat e gurit.
- Analiza për pllakat e gurit të trotuari.

- ***Në rast se analizat nuk janë kryer në emer të operatorit ekonomik por nga furnizuesi i tij, nuk përbën kusht për skualifikim.***

Argumentimi:

Kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Raport analizave është përcaktuar proporcionalisht dhe ne perputhje me objektin e kontrates, bazuar në nenin 77, te

LPP, si dhe nenin 40, par. 6, pika c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe është vendosur me qëllim që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë përputhshmerinë e mallrave me standartet teknike si dhe për të garantuar cilësinë dhe origjinalitetin e mallrave.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Termat e references, sasitë, specifikimet teknike janë hartuar nga personat përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike caktuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Nr.161 datë 13.05.2025.

Specifikimi I Materialeve janë si më poshtë:

Specifikimi i Materialeve:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Granil Pluhur 0-4 mm	m 3	2,000
2	Granil Misër 5-10 mm	m 3	1,000
3	Stabilizant	m 3	10,000
4	Çakull mak mbeturinë. 0-80 mm	m 3	15,900
5	Gurë kalldrëmi	m 2	1,000
6	Bordura guri 8x20	ml	300
7	Bordura guri 12x20	ml	100
8	Bordura guri 20x25	ml	50
9	Pllaka guri trotuari 30x20x3	m2	274
10	Gurë për mur	m 3	500
11	Çimento	kv	2,000
12	Gëlqere e shuar (Paketuar)	kg	1,000
13	Hekur	kg	4,000

1. Granil pluhur

Granili pluhur të jetë prej guri me dimension 0-4 mm. Granilet e imta për kategoritë e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do të jenë gurë të shoshitur, ose materiale të tjera inerte me të njëjtat karakteristika apo kombinim të tyre. E gjitha

kjo duhet të jetë pastruar shumë mirë, pa masa të mpiksura, cifla të buta e të veçanta, vajra distilimi, alkale, lëndë organike, argjile dhe sasi të substancave dëmtuese. Përmbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave të tjera dëmtuese është 5%. Materialet e marra nga gurë të papërshtatshëm për inerte të trasha nuk duhet të përdoren si inerte të imta. Inertet e imta të marra nga gurët e shoshitur duhet të jenë të mprehte, kubike, të fortë, të dendur dhe të durueshëm dhe duhet të grumbullohen në një platformë për të patur një mbrojtje të mjaftueshme nga pluhurat dhe përzierjet e tjera. Shkalla e shpërndarjes për inertet e imëta të specifikuara si më lart, duhet të jenë brenda kufijve të mëposhtëm. Masa e Sitës Përqindja që kalon (peshë e thatë) 10.00mm 100; 5.00mm 89 ne 100; 2.36mm 60 ne 100; 1.18mm 30 ne 100 ;0.60mm (600 um) 15 ne 100 ;0.30mm (300 um) 5 ne 70 ;0.15mm (150 um) 0 ne 15.

2. Granil miser

Granil miser të jetë prej guri me dimension 5-10 mm. Granilet e trasha për kategoritë e betonit A, B dhe C do të përbëhen nga materiale guri të thyer apo të nxjerrë ose një kombinim i tyre, me një masë jo më shumë se 20 mm, dhe do të jenë të pastër, të fortë, të qëndrueshëm, kubik dhe të formuar mirë, pa lëndë të buta apo të thermueshme, ose copëza të holla të stërgjatura, alkale, lëndë organike ose masa apo substanca të tjera të dëmshme. Lëndët dëmtuese në inerte nuk duhet të kalojnë me shumë se 3 %. Klasifikimi për inertet e trasha të specifikuara sa më sipër duhet të jetë brenda kufijve të mëposhtëm: Masa e sitës Përqindja e kalimit (në peshë të thatë) 50.0 mm 100 ;37.5 mm 90 ne 100; 20.0 mm 35 në 70; 10.0 mm 10 në 40 ;5.0 mm 0 në 5.

3. Stabilizanti

Stabilizanti është parashikuar të prodhohet me material gurore të thyer, të fraksionuar që plotësojnë kërkesat e mëposhteme:

- Fortësia e gurëve përbërës 800 kg/cm^2 . $\geq$
- Marka e thërmimit nga prova Losanxhelos, LA 30% . $\leq$
- Përmbajtja e argjilës deri ne 5 % dhe materialeve organik deri ne 3 %. Moduli i shkallëzimit të fraksioneve do të jetë sipas tabelës më poshtë:

Dimensioni i sitës në mm	Kalimi në sitë në %	Mbetja në site në %
71	100	0
40	100 - 65	0 - 35
25	75 - 35	25 - 65
10	70 - 30	30 - 70
5	55 - 23	45 - 77
2	40 - 15	60 - 85
0.4	25 - 8	75 - 92

00.75	15 - 2	85 - 98
-------	--------	---------

Pranohet luhatje 3 % $\pm$

Materiali i ngjeshur në vepër duhet të plotësojë kërkesat e më poshtme:

- Indeksi i plasticitetit IP 6 $\leq$
- CBR minimale 80 %
- Densiteti minimal i matur i shtresës së ngjeshur dhe të thatë duhet të jetë 98 % e vlerës Proktor i modifikuar.

4. Çakull mak. 0-80 mm

Materiali duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

- Indeksi i plasticitetit IP 10. $\leq$
- CBR minimale 30 %
- nuk duhet të përmbajë grimca me përmasa mbi 2/3 e trashësisë së shtresës, në sasi mbi 5%.

Çakull natyral i nxjerrë nga karrierat e gurit me shpërthime minash, që plotëson kërkesat e mëposhtme:

- Materiali guror duhet të ketë fortësinë 800 kg/cm². $\geq$
- Marka e thërmimit, nga prova Losanxhelos LA 30 %. $\leq$
- Përmbajtja e argjilës duhet të jetë më pak se 8 % dhe e mbeturinave bimore më pak se 5 %.
- Granulometria duhet të jetë e vazhduar me modul shkallëzimi sipas tabelës më poshtë:

Dimensioni i sitës në mm	Përqindja e kalimit sipas peshës (%)
100	100
75	80 - 100
40	60 - 85
25	50 - 70
10	40 - 55
5	30 - 50

5. Gurë kalldremit

Gurë kalldremit, Trashësi = 100 mm, i prerë në sharë

Materiali duhet të jetë i pastër, i nxjerrë nga karrierat e gurit me shpërthime minash.

Materiali guror duhet të ketë fortësinë 800 kg/cm²

6, 7, 8. Bordurat e Gurit

Bordurat e Gurit me një cep nga një anë të smusuar.

Bordurë guri -të mëdha Gjërësia 20 cm, Lartësia 25 cm, Gjatësia 100cm

Bordurë guri- të mesme Gjërësia 12cm, Lartësia 20cm , Gjatësia 100cm

Bordurë guri -të vogla Gjërësia 8 cm, Lartësia 20 , Gjatësia 100cm

Bordura e gurit do të ketë të njëjtat cilësi dhe veti si pllaka e gurit ranor. Bordurat do të jenë të prodhuara me përmasa e përmendura më sipër dhe me një cep nga një anë të smusuar

9. Pllaka guri trotuari

Gjatësia 30 cm, Gjërësia 20cm, Lartësia 3 cm

Pllakat e gurit ranor do të jenë të prera dhe trajtuar me Boçardim Pikësor +/-2mm, të parapërgatitura, t=3cm, dimensionet sipas përmasave të caktuara më lart .

Pllaka e gurit duhet ti plotesojë keto kritere teknike:

1. Rezistenca në shtypje $>150\text{N/mm}^2$
2. Rezistenca në përkulje $>15\text{ Mpa}$
3. Absorbimi $< 25\text{ mm}$ Tolerancat e lejuara për dimensione +/-2 mm sipas EN 1341:2001.

Pllakat e gurit duhet të nxirren nga shtresat e mesme dhe nuk duhet të kenë plasaritje, Pllakat e gurit para se të sillen në kantier paraprakisht duhet të kontrollohen në vendin e prodhimit ku njëherësh behet edhe seleksionimi i tyre. Pllakat të cilat nuk plotesojnë kriteret e kerkuar i hiqen dhe Kontraktori mban përgjegjësi për heqje dhe Transportin e tyre.

10. Gurë kave.

Materiali duhet të jetë i pastër, i nxjerrë nga karrierat e gurit me shpërthime minash.

Materiali guror duhet të ketë fortesinë 800 kg/cm^2

Nuk duhet të përmbajë fraksione të imta dhe prani argjile ose rrënje bimësie.

11. Çimento.

Çimento e zezë Marka 400

Kontraktori është i detyruar që për çdo ngarkesë çimentoje të prurë në objekt, të paraqesë faturën e blerjes e cila të përmbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar që çimentoja e secilës ngarkesë është e kontrolluar dhe me analiza sipas standarteve.

Për më shumë detaje në lidhje me markën e çimentos që duhet përdorur në prodhimin e betoneve, shiko në pikën pasi për marka betoni të ndryshme duhen përdorur marka çimento të ndryshme.

Çimentoja duhet të depozitohet në ambiente pa lagështirë dhe që nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.

Çimento a.) Çimento Portland e Zakonshme do të përdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-të ose Tipi V-të. Kjo do të përdoret aty ku betoni nuk është në kontakt me ujëra të zeza, tub gazi

ose ujërat nëntokësore. b.) Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do të përdoret me BS 4027. Kjo do të përdoret për strukturat e betoneve duke përfshirë pusetat dhe të gjitha përkatësitë e tjera në kontakt me ujërat e zeza, tubin e gazit ose ujërat nëntokësore.

12. Gelqere e shuar e paketuar në qese 10/50 kg.

13. Hekur ndërtimi

Hekur ndërtimi 8 mm, 10 mm, 12 mm, 16 mm, 18 mm Hekuri i ndërtimit për të gjitha strukturat e përforcuara të betonit dhe materialeve me përbërës hekuri që prodhohen në shesh duhet që hekuri të plotësojë këto kërkesa: Tipi C-3, me $R_a = 2.100 \text{ kg/cm}^2$ dhe pa ndryshk, me masa dhe forma në përputhje me vizatimet dhe standartet teknike legale për hekurat e punës, bashkimet etj., dhe të jenë të shoqëruara me një çertifikatë që të vërtetojë që hekuri përmbush të gjitha kërkesat për punën që do të kryhet.

Specifikimet teknike janë hartuar pas verifikimeve të kryera në lidhje me nevojat për material ndërtimi që ka ndërmarrja duke u bazuar edhe në përvizime të viteve të mëparshme.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi :

Kjo kontratë ka për qëllim realizimin e furnizimit me material të ndryshme ndërtimi.

Kontraktuesi duhet të furnizojë me mallra në përputhje me standartet e kërkuara dhe specifikimet teknike me shpenzimet e tij deri në dorëzimin në vendin e përcaktuar që është magazina e ndërmarrjes së Shërbimeve publike, Bashkia Korçë.

Afati

12 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Materialet janë kërkuar sipas sasive dhe nevojave efektive për të përmbushur nevojat e ndërmarrjes në mënyrë të plotë për realizimin e shërbimeve në interes të komunitetit. Materialet janë specifikuar në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për të qënë sa më rezistente dhe të dukshme në rrugë, gjithashtu që do të përmbushin të gjitha standartet rrugore.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

*cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,**duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

Pellumbesha Nurçe

Shefe Prokurimesh

Sofia Skllavi

Juriste

Liljana Myrtollari

Specialiste prokurimesh